



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Milenium Konstruktion” Sh.P.K. të datës 27.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 23.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i kolektorit të vazhdimi i rrugës B (faza 4)” me nr. të prokurimit 616-23-13472-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Milenium Konstruktion” Sh.P.K. e datës 27.02.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i kolektorit të vazhdimi i rrugës B (faza 4)” me nr. të prokurimit 616-23-13472-5-2-1 ashtu që **ANULOHE**T njoftimi mbi vendimin i datës 23.02.2024 i autoritetit kontraktues ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në **RIVLERËSIM**.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Milenium Konstruktion” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Milenium Konstruktion” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 27.02.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 23.02.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i kolektorit të vazhdimi i rrugës B (faza 4)” me nr. të prokurimit 616-23-13472-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë: Sa i përket arsyes së parë për eliminimin ju konfirmojmë se në ofertën tonë do të gjeni të bashkangjitura dy (2) lista të projekteve – anekse 6 të dosjes së tenderit. Në listën e liderit të grupit “Milenium Konstruktion” do të gjeni të listuara shtatë projekte të natyrës së ngjashme me kontratën, vlera e përgjithshme e të cilave është rreth 1.6 milion euro. Ngjashëm edhe në listën e kontratave të anëtarit të grupit “ILEAA-GR” do të gjeni të listuara shtatë (7) projekte të natyrës së ngjashme vlera e përgjithshme e të cilave është rreth 7.9 milion euro. Pra në total ne si grup i operatorëve ekonomik kemi dorëzuar dëshmitë e kërkuara me dosjen e tenderit sipas të cilave mund të konfirmohet pa mëdyshje se kemi realizuar kontrata në vlerë mbi 9.5 milion euro së bashku në tri vitet e fundit respektivisht 15.5 herë më shumë sesa që është kërkuar me dosjen e tenderit. Të gjitha këto dëshmi janë të bashkangjitura me ofertën tonë dhe si të tilla mund të konfirmohen me rastin e administratimit të ofertës tonë si provë me qëllim të vendosjes mbi këtë kërkesë për rishqyrtim. Prandaj arsyeja e parë për eliminim është e pabazuar.

Pretendimi i dytë: Sa i përket arsyes së dytë për eliminimin ju konfirmojmë se lideri i grupi “Milenium Konstruktion” ka dorëzuar listën e kontratave sipas aneksit 6 të dosjes së tenderit përmes të cilës ka dëshmuar se në tri vitet e fundit ka realizuar kontrata në vlerë të përgjithshme rreth 1.6 milion euro. Pra jo vetëm që është përmbushur kërkesa sipas të cilës lideri duhet të ketë realizuar projekte në vlerë së paku 60% të vlerës 600,000.00 euro të kërkuar me dosjen e tenderit. Në fakt vetëm lideri si i vetëm e ka përmbushur dhe e ka tejkalluar këtë vlerë. Të gjitha këto dëshmi janë të bashkangjitura me ofertën tonë dhe si të tilla mund të konfirmohen me rastin e administratimit të ofertës tonë si provë me qëllim të vendosjes mbi këtë kërkesë për rishqyrtim. Prandaj edhe arsyeja e dytë për eliminim është e pabazuar në tërësi.

Pretendimi i tretë: Sa i përket arsyes së tretë për eliminimin ju konfirmojmë se ne kemi dorëzuar dëshmitë e kërkuara dokumentare sipas të cilave inxhinieri ynë i ndërtimtarisë ka përvojë të punës mbi 12 vite pra dukshëm më shumë sesa është kërkuar me dosjen e tenderit. Të gjitha këto dëshmi janë të bashkangjitura me ofertën tonë dhe si të tilla mund të konfirmohen me rastin e administratimit të ofertës tonë si provë me qëllim të vendosjes mbi këtë kërkesë për rishqyrtim. Prandaj arsyeja e tretë për eliminimin është e pabazuar.

Pretendimi i katërt: Sa i përket arsyes së katërt për eliminimin ju konfirmojmë se për inxhinierin tonë të ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknikë z. Mexhid Zylfiu ne kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara dokumentare (diplomë, CV, Referenca, kontrata e punë). Të gjitha këto dëshmi janë të bashkangjitura me ofertën tonë dhe si të tilla mund të konfirmohen me rastin e administratimit të ofertës tonë si provë me qëllim të vendosjes mbi këtë kërkesë për rishqyrtim. Prandaj edhe kjo arsye është e pabazuar në tërësi.

Pretendimi i pestë: Sa i përket arsyes së pestë për eliminimin ju konfirmojmë se për inxhinierët tanë Anita Sadikaj dhe Rikard Matoshi ne kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara dokumentare. Të gjitha këto dëshmi janë të bashkangjitura me ofertën tonë dhe si të tilla mund të konfirmohen me rastin e administratimit të ofertës tonë si provë me qëllim të vendosjes mbi këtë kërkesë për rishqyrtim. Prandaj edhe kjo arsye është e pabazuar në tërësi. Prandaj kjo arsye është e pabazuar në tërësi.

Pretendimi i gjashtë: Sa i përket arsyes së gjashtë për eliminimin ju konfirmojmë se për teknikët tanë të ndërtimtarisë Ganimete Krasniqi dhe Tasim Gashi ne kemi dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara dokumentare. Të gjitha këto dëshmi janë të bashkangjitura me ofertën tonë dhe si të tilla mund të konfirmohen me rastin e administratimit të ofertës tonë si provë me qëllim të vendosjes mbi këtë kërkesë për rishqyrtim. Prandaj edhe kjo arsye është e pabazuar në tërësi.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se arsyet për të cilat është eliminuar parashtruesi nga aktiviteti i prokurimit janë formuluar si në vijim:

1. Nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme se ju keni përfunduar kontrata në vlerë minimale prej 600,000.00 euro të punëve në veprimtarinë e rregullimit apo ndërtimit të lumenjëve, kolektorëve apo ujësjellësit.
2. Lideri i grupit në arrin vlerën e 60% të vlerës 600,000.00 euro sipas kërkesës në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.
3. Inxhinieri i ndërtimtarisë nuk ka plotësuar përvojën e punës minimum 7 vite pas diplomimit sipas kërkesave të kërkuara në njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit.
4. Mexhid Musliu ing. i hidroteknikës nuk ka plotësuar kërkesat e njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit pasi që nuk ka ofruar dëshmi për përvojën e punës.
5. Anita Sadikaj, Rikard Matoshi inxhinier të ndërtimtarisë nuk kanë plotësuar kërkesat e kërkuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit pasi që nuk ka ofruar dëshmi për përvojën e punës.
6. Teknikët e ndërtimtarisë Ganimete Krasniqi dhe Tasim Gashi nuk kanë plotësuar kërkesat e kërkuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit pasi që nuk ka ofruar dëshmi për përvojën e punës.

Nga administrimi i ofertës me të cilën ka tenderuar parashtruesi është gjetur se i njëjti ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar kontrata në vlerë minimale prej 600,000.00 euro të natyrës së kontratës ku lideri i grupit ka dëshmuar se ka përfunduar me sukses më shumë se 60% të vlerës së këtyre kontratave. Njëkohësisht është gjetur se parashtruesi ka përmbushur edhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me stafin profesional të kërkuar sipas dosjes së tenderit në kuptim të arsyeve me nr. 3-6 të evidentuara në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar. Rrjedhimisht është konstatuar se nuk janë përmbushur kriteret ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit në kuptim të nenit 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Në këtë mënyrë është gjetur se komisioni vlerësues nuk ka vepruar në përputhje me nenin 59 lidhur me nenin 62 të LPP dhe 40 lidhur me nenin 43 të RRPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.02.2024

Visar SHEHU



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.